

Përmasat e Sektorit Publik¹

Studim i paraqitur në

Konferencën e Katërt të Bankës së Shqipërisë me temë
Ekonomia Shqiptare: Arritjet dhe Sfidat e Politikës Ekonomike
Sarandë, Shqipëri, 11-12 shtator 2003

Përmbledhje

Ky punim ka si qëllim të shtjellojë në mënyrë të përgjithshme rolin e shtetit parë në një këndvështrim teorik. Punimi fillon me shqyrtimin e faktorëve që e bëjnë të nevojshëm përfshirjen e sektorit publik në ekonominë e tregut. Në këtë kontekst, synimi i efikasitetit shpërndarës luan një rol të rëndësishëm. Autorët tregojnë se konfliktet e racionalitetit dhe objektivat shpërndarës ndikojnë në përfshirjen e sektorit publik. Gjithashtu, punimi paraqet në hollësi sesi politikatat ekonomike të jetës së përditshme përvetësojnë dështimin e tregut dhe realizojnë objektivat shpërndarës. Këtu analizohet ndër të tjera edhe çështja e përmasave të sektorit publik. Siç argumentohet edhe nga një këndvështrim ekonomik, kjo çështje mund të trajtohet vetëm nëse dihet se në ç'masë aktiviteti i sektorit publik kufizon burimet ekonomike. Përmasat e shpenzimeve si edhe ato të të ardhurave nuk e pasqyrojnë aq sa duhet këtë pohim duke qenë se shpenzimet e fshehura nuk merren parasysh. Së fundmi, jemi munduar të vlerësojmë sesa është zhvilluar sektori publik në Shqipëri gjatë viteve '90 krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

nga

Dhori Kule

Profesor dhe dekan në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
e-mail: dhorikule@usa.net

H.-Dieter Wenzel

Profesor (Ekonomia Publike) dhe drejtor i Grupit të Kërkimeve Ekonomike të Bambergut, mbi Qeverinë dhe Rritjen (GKEB)
Universiteti Bamberg, Gjermani
e-mail: public-finance@sowi.uni-bamberg.de

¹ Autorët falenderojnë Jörg Lackenbauer, Björn Saß dhe Julia Bersch për komentet e vlefshme dhe për ndihmën në mbledhjen e materialeve.

1 Hyrje

Raporti mbi Zhvillimin Botëror i vitit 1997 iu kushtua rolit dhe efikasitetit të shtetit. Çfarë duhet të bëjë shteti, si duhet ta bëjë këtë dhe si mund ai t'i bëjë detyrat e tij më mirë në një botë që ndryshon vullshëm – këto ishin disa nga aspektet kryesore të këtij publikimi vjetor të Bankës Botërore botuar para gjashtë vjetësh². Mbas Luftës së Ftohtë dhe rënies së ekonomive të komanduara, shumica e vendeve në tranzicion – në valën e parë të entuziazmit të çlirimit nga zinxhirët e mbrojtjes mbytëse të shtetit – kishin si moto: sa më i vogël sektori publik, aq më mirë. Në shumë nga ato vende zor se kuptohej se shteti luan një rol të rëndësishëm edhe në ekonomitë e tregut bazuar në konkurrencë. Duheshin dhe akoma duhet shumë fuqi bindëse për ta bërë të qartë këtë.

Shumë njerëz nga vendet në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore mbetën të befashuar nga fakti se vendet perëndimore ishin vende me ekonomi mikse dhe jo me ekonomi të pastra tregu. Megjithatë, duhet parë ende nëse në vendet në tranzicion raporti i shpenzimeve qeveritare ndaj prodhimit të përgjithshëm kombëtar (një matës tipik i influencës së shtetit) është shumë më i lartë se 40 për qind (dhe pjesërisht më shumë se 50 për qind), ashtu siç është rregull në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, atëherë ky është një shembull që ia vlen të ndiqet. Për më tepër, është e paqartë nëse Evropa nuk duhet t'i drejtohet raporteve të shpenzimeve qeveritare ndaj PBB-së, që janë edhe më të ulta se në SHBA (tani rreth 32 për qind).

Ky punim ka si qëllim të shqyrtojë në mënyrë të përgjithshme rolin e shtetit, i parë në një këndvështrim teorik. Kështu që, vëmendje e veçantë i është dhënë faktit se si justifikimet tradicionale mbi aktivitetin e sektorit publik duhen adoptuar nën dritën e globalizimit të vazhdueshëm të tregjeve dhe të integritit të sistemeve politike.

Në këtë punim kemi përdorur termat “shteti”, “publik(e)” dhe “qeveri” në gjuhën e folur, siç bëhet shpesh nëpër diskutime dhe shkrime. Dhe ne e konsiderojmë shtetin të përbërë nga tre pushtete të veçanta, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Nga këndvështrimi i ekonomisë publike, tre aktivitetet e sektorit publik që rrjedhin prej saj janë me interes të veçantë: shpenzimet e qeverisë, taksat e qeverisë dhe rregullorja qeveritare mbi aktivitetet e tregut privat.

Një aktivitet i katërt, po aq i rëndësishëm në aktivitetin e sektorit publik, nuk duhet harruar: financimi i borxhit, domethënë fuqia që ka shteti për të marrë hua. Edhe në qoftë se fuqitë huamarrëse nuk i përkasin fuqive detyruese të shtetit (duke qenë se bonot e qeverisë blihen zakonisht vullnetarisht), ato kanë të njëjtin efekt mbi brezat e ardhshëm si taksë, dhe kjo vjen si pasojë e kalimit të ngarkesës së interesit.³

Kështu, në qoftë se në këtë punim flasim rreth “përmasave të sektorit publik”, “përmasat” i kuptojmë të matura nga katër aktivitetet e sektorit publik që u përmendën më lart.

² BANKA BOTËRORE (1997, p. III).

³ Duke qenë se financimi i borxhit të sektorit publik kryhet pa kufizuar pavarësinë e atyre që blejnë bono, dikush mund të arrijë në përfundimin se financimi i borxhit është instrumenti më i përshtatshëm në ekonomitë e tregut. Po këtu nuk flitet për këtë, sepse kontratat (afatgjata) të financimit të borxhit futen pa marrë parasysh palët e treta të prekura (domethënë brezat e ardhshëm).

Përpara se të përpiqemi të matim “përmasat”, do të donim të shqyrtonim arsyet e përfshirjes së sektorit publik, duke qenë se përmasa dhe shtrirja duhet të rrjedhin nga një analizë e justifikimeve të aktiviteteve publike.

Kështu, në pjesën e dytë të këtij punimi, qëllimi ynë është të shqyrtojmë faktorët që e bëjnë të nevojshme përfshirjen e sektorit publik në ekonominë e tregut. Synimi i efikasitetit shpërndarës dhe Teorema e Parë Themelore e Teorisë së Mirëqenies, luajnë një rol kryesor në këtë kontekst. Kështu, tregojmë se konfliktet e racionalitetit dhe të objektivave shpërndarës janë shkaqet e përfshirjes së sektorit publik.

Pjesa e tretë i dedikohet në mënyrë të veçantë fushave përkatëse të aktivitetit të sektorit publik. Do të tregojmë me hollësi sesi politika ekonomike e jetës së përditshme përvetëson dështimin e tregut dhe realizon objektivat shpërndarës.

Pjesa e katërt ka të bëjë me çështjen e matjes së përmasave të sektorit publik. Kemi treguar se nga një këndvështrim ekonomik, kjo çështje mund trajtohet vetëm nëse dihet se në ç’masë aktiviteti i sektorit publik kufizon burimet ekonomike. Përmasat e shpenzimeve dhe ato të të ardhurave nuk e pasyrojnë aq sa duhet këtë pohim duke qenë se shpenzimet e fshehura nuk merren parasysh.

Në pjesën e pestë, në bazë të të dhënave që disponojmë, do të vëzhgojmë sesi sektori publik në Shqipëri është zhvilluar gjatë viteve '90 krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Punimi mbyllet me një rresht të shkurtër në fund mbi parimet ekonomike të “politikave të mira të sektorit publik”.

2 Përse aktiviteti i sektorit publik?

Ka disa arsye që e justifikojnë rolin e sektorit publik edhe në një ekonomi tregu bazuar në konkurrencë. Këto arsye rezultojnë nga fakti se parimet që përbëjnë ekonominë e tregut mund ose të mos zbatohen ose të zbatohen pjesërisht. Me “parime përbërëse” kuptojmë, sipas Walter Eucken (1952):

- rregull mbi pronën private;
- vendosje e lirë e çmimeve dhe konkurrencë perfekte;
- liri në kryerjen e marrëveshjeve;
- mekanizma që lejojnë funksionimin e tregut;
- parashikueshmëri të politikave ekonomike.

Një përfundim i rëndësishëm i teorisë së mirëqenies tregon se të ashtuquajturit ekuilibrat konkurrues, që rrjedhin nga parimet e sipërpërmendura, janë **Pareto eficientë** (Pareto efficient). Ky është një argument i fortë në favor të superioritetit të sistemeve të sipërmarrjes së lirë konkurruese. Me të vërtetë, me tregjet funksionale, rezultatet e ardhshme të tregut nuk mund të përmirësohen në qoftë se janë frutdhënës Pareto. Megjithatë, efikasiteti Pareto nuk na provon nëse fitimet e marra dhe shpërndarja e pasurisë mund të konsiderohen të ndershme dhe të pranueshme nga shoqëria.

Duke përmbledhur këto që thamë, ekziston një mundësi, në dy aspekte, për përfshirjen e një pale të jashtme që gëzon fuqi detyruese – shteti. Fillimisht, në rast të shfaqjes së një joefikasiteti shpërndarës nga një mospërputhje e racionalitetit individual të

pjesëmarrësve të tregut nga njëra anë dhe racionalitetit kolektiv, nga ana tjetër (që është më me avantazh për ekonominë në përgjithësi). Ky quhet **konflikti i racionalitetit**. Së dyti, në qoftë se efikasiteti shpërndarës nuk çon në një përfundim shpërndarës të dëshirueshëm dhe “të ndershëm”, ky quhet **konflikt i shpërndarjes**.

Në literaturën e Financës Publike është e pamohueshme se synimi i efiaksitetit si edhe synimi i shpërndarjes janë themelet e justifikimit të aktivitetit të sektorit publik në ekonominë e tregut të mbështetura në konkurrencë, e për rrjedhojë ato legjitimojnë vetë ekzistencën e sektorit publik. Është më e diskutueshme nëse një synim i tretë, synimi i qëndrueshmërisë formuluar nga Richard A. Musgrave (1959), ka të njëjtën rëndësi. Ka disa mundësi ekstreme, që pretendojnë se mekanizmat kontrollues makroekonomikë të sektorit publik gjenerojnë madje edhe vetë ciklet e biznesit që ata kanë si qëllim t'i luftojnë.

Duke e lënë mënjanë këtë aspekt për tani, do të donim të shikonim më nga afër dy synimet e përmendura në fillim. Në qoftë se ato do t'i vendosnim sipas një renditjeje të politikave ekonomike të jetës së përditshme dhe të politikave buxhetore, atëhere eficientia si synim do të ishte – pa asnjë dyshim – më i rëndësishëm parë nga këndvështrimi i mirëqenies. E shprehur në mënyrë figurative, eficientia shpërndarëse është mëse e domosdoshme për të pasur një tortë sa më të madhe. Një shpërndarje e drejtë e copës më të vogël së tortës (nëse nuk ka efikasitet shpërndarës) nuk i shërben askujt.

Kështu, nëse shpërndarja efikase e burimeve është synimi i parë i një ekonomie tregu të bazuar në konkurrencë, sërish na duhet të kërkojmë se cilat janë situatat tipike të konflikteve të racionalitetit në aktivitetin ekonomik të jetës reale dhe në këtë mënyrë, të kërkojmë përfshirjen e sektorit publik.

Në të vërtetë, situata të tilla ka shumë. Në shumë tregje për shembull, përgjithësisht ka një ofertë jomaksimale të të **mirave publike**, sepse mungesa e rivalitetit dhe papërgjashtëshmëria në konsum i bën përdoruesit racionalë privatë, të përfitojnë (sillen si *free riders*) dhe t'i fshehin preferencat e tyre.

Megjithatë, në mjaft raste, të **mirat private**, gjithashtu, nuk mund të kenë një shpërndarje efikase nëpër treg. Kjo ndodh kur tregjet nuk arrijnë të përvetësojnë efektet shoqëruese (*spillover effects*) të gjeneruara nga të **mirat private**. Në rastet e ndikimeve të jashtme negative, kemi një ekstraofertë të këtyre të mirave, kurse në rastet e ndikimeve të jashtme pozitive ndodh e kundërta, mungesë oferte.

Mungesa e të drejtave të pronës private të individit mund të çojë, gjithashtu, në një shpërndarje joefikase. E kaluara e afërt, qoftë ajo e ish-Republikës Demokratike Gjermane apo në vendet të tjera post-socialiste, ka treguar në mënyrë alarmante se çështja e të drejtave të pronës së përbashkët ishte një çështje thelbësore e mbishfrytëzimit sistematik të burimeve ekonomike. Kombinimi i këtyre dy shkaqeve të fundit të dështimit të tregut, njihet në ekonomiks me emrin **Tragjedia e Pronës së Përbashkët** (*Allmende Problem* në gjuhën gjermane). Edhe sot, ky lloj konflikti i racionalitetit është ende tipik në mjaft probleme të efikasitetit.

Problemi i **fuqisë së tregut dhe informacionit asimetrik apo të pamjaftueshëm**, veçanërisht në ekonominë në tranzicion, shkakton shpeshherë rënie të mirëqenies

ekonomike. E njëjta gjë është e vërtetë për privatizimin e nxituar të strukturave të prodhimit, që karakterizohen nga **ekonomi të shkallës**.

Numërimi mund të vazhdojë, por që në këtë pikë mund të vëmë re se për shkak të morisë së paefektshmërisë shpërndarëse, tregjet nuk duhen “lënë tërësisht vetëm”.

Në kapitullin vijues, do të donim të ilustronim me shembuj se në ç’ fusha dhe në ç’mënyrë aktiviteti i qeverisë është i nevojshëm për përmirësime të mirëqenies.

3 AKTIVITETI I SEKTORIT PUBLIK DHE I CILIT LLOJ?

Në parim, shteti ka tre mundësi ndërhyrjeje: nëpërmjet politikës së të ardhurave, politikës së shpenzimeve dhe politikës legjislativë (domethënë ligjeve, direktivave etj.). Secili nga këta instrumente duhet përdorur fillimisht për të kontrolluar ekonominë. Parimi bazë duhet të jetë i tillë që të ndryshojë kushtet e sistemit për vendimet private në një mënyrë që racionaliteti individual dhe racionaliteti kolektiv të jenë reciprokisht të pajtueshëm, dhe jo një parim që largon dështimet e tregut nëpërmjet urdhërave, ndalimeve apo formave të tjera të masave direkte shtrënguese. Është e qartë se pikërisht taksat nuk i plotësojnë këto kërkesa. Dhe ja përse politika e taksave nga njëra anë nuk është një instrument kaq i thjeshtë për shtetin, por megjithatë, nga ana tjetër është mjaft e vështirë të arrish një politikë të mirë taksash. Taksat gjithashtu, duhen përdorur fillimisht për të kontrolluar ekonominë. Synimi fiskal i taksimit qëndron vetëm deri aty sa të financohen shpenzimet e nevojshme.

Rrjedhimisht, sekretet e një politike të drejtë të takasve është të evitohet sa më shumë të jetë e mundur çrregullimin e strukturave të çmimeve në treg.

Në pjesën vijuese duam të ilustrojmë me anë të disa shembujve se si paefektshmëritë shpërndarëse mund të mënjanojnë nëpërmjet përdorimit të llojeve të instrumenteve të lartpërmendura. Duhet të kujtojmë se transfertat apo subvencionet nuk janë gjë tjetër veçse taksa negative dhe borxhi publik është një burim të ardhurash i llojit të veçantë.

3.1 TË MIRAT PUBLIKE

Shembuj të të mirave publike janë sistemi ligjor, mbrojtja kombëtare, dega e gjyqësorit, ligji dhe rregulli në një vend, mbrojtja e burimeve natyrore dhe infrastruktura. Këto shërbime i vlejné kujtdo, por për shkak të mungesës së rivalitetit dhe të papërfundueshmërisë në konsum, këto nuk mund të ofrohen nga privatët. Shteti mund t’i prodhojë këto të mira vetëm ose t’ia prodhojnë të tjerë. Në të dyja rastet prodhimi kërkon shpenzime. Shpenzimet duhet të financohen nga buxheti, sepse sjellja e “kalorësit të lirë” e bën të pamundur shpërndarjen e bazuar në treg. Duke qenë se nuk ka çmim tregu për të mirat publike, vlera e tyre llogaritet nëpërmjet kostove të prodhimit. Në këtë kontekst, bëhet fjalë për **shpenzime të konsumit publik**.

Në Gjermani, shpenzimet e këtij lloji zënë afërsisht 20 për qind të PBB-së, dhe ky raport ka qenë relativisht i qëndrueshëm përgjatë viteve. Duke patur një raport të shpenzimeve të qeverisë dhe PBB⁴ rreth 50 për qind, shpenzimet e konsumit publik zënë jo më pak se 40 për qind të totalit të shpenzimeve publike. Duke qenë se shpenzimi i konsumit publik nuk është një artikull me attribute, ekziston një arsye e fortë për t’i financuar këto

⁴ Shpenzimet e të gjitha autoriteteve territoriale duke përfshirë dhe sistemet e sigurimeve shoqërore zinin 48.6 për qind në Gjermani në vitin 2002.

shpenzime nga buxheti ushtrimor. E njëjta gjë vlen edhe për përdorimin e infrastrukturës ekzistuese deri në nivelin e zhvlerësimit ekonomik. Një rritje e gjendjes kapitale përtej kësaj do të ishte ekuivalente me investimin publik neto, që gjeneron dobi ndërkohore dhe që do të duhet të financohet nga buxheti kapital⁵.

3.2 Ndikimet përfituese

Ndarja ndërmjet të mirave publike dhe ndikimeve përfituese nuk është gjithmonë e qartë. Përse fushat e arsimit, të uversiteteteve, ato kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit, e ato të shëndetit përmenden në këtë paragraf dhe jo në atë të fundit? Kjo ndodh sepse këto mallra karakterizohen nga dalje dinamike dhe ndërkohore. Vetëm shpenzimet për arsimimin publik (shkollat, gjimnazet, universitetet) arrijnë në një konstante relative prej 4 për qind të PBB-së në Gjermani çdo vit (ose 8 për qind të shpenzimeve totale të qeverisë). Faturat e arsimit ngrenë një argument të fuqishëm, i cili do të lejonte një përpunim të çmimeve në tregun e arsimit, në vend të financimit të sektorit publik nëpërmjet taksave. Kjo nuk do të ishte e padrejtë nga ana sociale nëse njerëzit nevojtarë, që janë të talentuar, të mund të financohen nëpërmjet subvencioneve që mbështesin arsimimin.

Këto fatura të arsimit duhet të jenë të vlefshme për çdo fushë të tij. Kjo do të mundësonte një shpërndarje neutrale, që nuk mund të arrihet nëse arsimi i lartë subvencionohet gjerësisht dhe ku hyrja të ishte e lirë (si në mjaft vende evropiane).

Çështja ndryshon tërësisht përse i takon daljeve në fushën e mjedisit. Teoria tregon se daljet negative mund të përvetësohen nëpërmjet taksimit si edhe subvencionimit të palës përgjegjëse. Përse i takon efekteve shpërndarëse, të dyja mënyrat janë ekuivalente. Megjithatë, një subvencion për pakësimin e ndotjes sjell probleme buxhetore, dhe në të njëjtën kohë nxitje negative për ndotjet e tjera të mundshme. Është përvetësimi i daljeve negative që tregon mjaft qartë karakterin kontrollues të të ashtuquajturës taksë Pigoruviane. Në këtë kontekst, një taksë e mirë është ajo që bëhet vetë e panevojshme.

3.3 Prona private

Pa asnjë dyshim, kjo fushë përbën një nga detyrat më të rëndësishme të sektorit publik: krijimi dhe sigurimi i pronës private. Shpenzimet e lidhura me këto detyra duhen kërkuar në financimin e ligjit dhe të rregullit si edhe të sistemit ligjor në një vend. Gjatë procesit të tranzicionit, këto shpenzime kanë edhe anën e të ardhurave: ecuria e privatizimit. Në praktikë, gjërat shpeshherë duken krejt ndryshe. Kjo ndodh sepse shitja e ndërarrjeve shpesh lidhet me kërkesat e politikës sociale apo të atyre të tregut të punës. Në vitet 1990-të, kjo praktikë në Gjermani çoi në humbje të jashtëzakoshme të Treuhandanstalt-it, dhe ishte përgjegjëse për privatizimin e ndërmarrjeve publike të ish-Republikës Demokratike të Gjermanisë. Përveç kësaj, kjo strategji na tregoi se zhvillimi i ndërmarrjeve private ishte gjithashtu i ngadaltë. Akoma sot, Gjermania duhet të mbartë pasojat e këtij privatizimi jo të suksesshëm, sepse nevoja për të transferuar fonde nga perëndimi në lindje arrin ende afërsisht në 80 miliardë euro çdo vit. Më shumë se gjysma e raportit të deficitit gjerman dhe PBB-së, që sot e kalon kufirin prej 3 për qind të vendosur nga Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes së Bashkimit Evropian, mund t'i atribuohet privatizimit publik jo të suksesshëm.

⁵ Në Gjermani, shpenzimet vjetore për investimet publike janë llogaritur që të plotësojnë kërkesat e nenit 115 të ligjit themelor gjerman (German Grundgesetz), i cili parashikon se huamarrjet vjetore neto nuk duhet të kalojnë shpenzimet për investimet publike.

Një mësim i përgjithshëm nga kjo strategji do të ishte: një privatizim i shpejtë pa kërkesat e politikës së tregut të punës, kursen shpenzime dhe sjell para. Nëse do të bashkonim privatizimin dhe objektivat e politikës sociale, gjithsesi, kjo do të çonte në të kundërtën.

3.4 Problemi i pronës private

Problemi i pronës private i ka rrënjët në mungesën e të drejtës mbi pronën private, gjë që çon në mungesë të nxitjeve për një përdorim efikas të burimeve. Nëse mallrat përkatës janë të rrallë, atëherë kemi të bëjmë me një problem. Po marrim shembullin e përdorimit të lirë të ujit dhe të energjisë nga popullsia. Në politikën ekonomike të jetës reale, praktika të tilla njihen si “sociale”. E kundërta është e vërtetë. Nëse çmimet e tregut do të ndryshonin, kjo do të pasqyroste kostot e prodhimit, dhe nëse konsumatorëve nevojtarë do t’u bëhej transfertë të ardhurash, do të kishte përfitime në mirëqenie për të gjithë siç thuhet edhe në teorinë e financës publike. Kështu, ekziston, një domosdoshmëri në dy mënyra sesi qeveria mund të veprojë. Nga njëra anë, ajo duhet të sigurojë furnizimin me mallra të tillë në të gjithë tregun – nëse është e nevojshme duke privatizuar burimin e ofertës së këtyre mallrave – dhe nga ana tjetër, ajo duhet të sigurojë – nëpërmjet transfertave në të ardhura – që të gjithë individët të mund të financojnë nevojat e tyre themelore.

Mjedisi është një tjetër shembull i rëndësishëm. Mbi mjedisin nuk ka të drejta përdorimi. Dhe pasoja do të ishte mbishfrytëzimi nëpërmjet ndotjes së mjedisit. Kjo reflekton racionalitetin individual, por është e dëmshme për objektivat e përgjithshëm të ekonomisë. Po marrim shembullin e zhvillimit të turizmit. Këtu, kostot e mundësisë, për shkak të rasteve të humbura të zhvillimit, mund të çojnë në humbje neto të pasurisë për të gjithë (edhe për ndotësit) nëpërmjet dëmtimeve të mjedisit. Është mëse e qartë se në këtë rast ka nevojë për kufizime ligjore nga ana e qeverisë.

3.5 Informacioni asimetric dhe tregje të papërfunduara

Informacioni asimetric në të dyja anët e tregut është kushti më i rëndësishëm për shpërndarje efikase. Shembulli i famshëm, tregu-limon i George Akerlof (1970) e ilustron më së miri këtë. Ç’mund të bëjë sektori publik në këtë rast? Duke qenë se konsumatorët kanë disavantazhe tipike nga informacioni joperfekt, një strategji e sektorit publik, e afërt me tregun, do të ishte ajo që përfshin institucione subvencionuese që kujdesen për informimin e konsumatorit mbi cilësinë dhe çmimet e mallrave të ofruar.

Kjo do të ishte racionale për individin, por jo optimale. Shembulli i Gjermanisë tregon që në praktikë, shteti mund të jetë pjesë e marrëveshjes mes brezave në dy mënyra. Së pari, nëse vepron për të siguruar shlyerjen e Fondit të Sigurimeve Shoqërore (Gesetzliche Rentenversicherung, GRV), që çdo vit tregon shpenzimet që arrijnë përafërsisht vëllimin e buxhetit të qeverisë qendrore⁶. Së dyti, shteti financon përmes buxhetit të qeverisë qendrore, përafërsisht një të tretën e shpenzimeve lidhur me FSS⁷. Raporti i bashkëfinancimit është gjithashtu, një pasojë e ribashkimit joekonomik të suksesshëm të Gjermanisë, që pati dhe një sforcim të stërmadh mbi marrëveshjen mes brezave. Kjo bëhet akoma më e qartë po të shikojmë buxhetin e sigurimeve shoqërore të Gjermanisë, që mbulon rreziqet e mëdha të jetës si pleqëria, sëmundjet, papunësia

⁶ Në vitin 2002, shpenzimet e FSS-së arritën afërsisht në 230 miliardë euro, rreth 13 për qind të PBB-së.

⁷ Për vitin 2003, pagesat e përgjithshme të qeverisë ndaj FSS nga 77 miliardë euro janë hequr tashmë mënjane.

dhe aksidentet. Në vitin 2002, shpenzimet për mirëqenien sociale arritën afërsisht në një të tretën e PBB-së. 50 për qind e saj u financua nga sektori publik, 20 për qind nga kompanitë private dhe vetëm 30 për qind nga palët e siguruara vetë. Ky shembull tregon dy gjëra. Nga njëra anë, sektori publik ka rolin e tij si palë kontratuese në marrëveshjen mes brezave. Nga ana tjetër, gjithsesi, ai nuk duhet të bëhet financuesi më i madh i rreziqeve të mëdha të jetës private.

3.6 Fuqia e tregut dhe të ardhurat në rritje sipas shkallës

Humbjet ekonomike në situata kur fuqia e tregut (monopoli apo oligopoli etj.) rezultojnë nga fakti se prodhuesit vënë çmime që janë shumë të larta, krahasuar me një situatë të konkurrencës perfekte, dhe kur sasia e ofruar është shumë e ulët. Në rastet e monopoleve të zakonshme të tilla situata nuk kanë domosdoshmërisht nevojë për ndërhyrjen e qeverisë. Për këtë jepen dy arsye. Së pari, përfitimet e monopolit mund të jenë një shpërblim për sipërmarrësit inovatorë Schumpeterian – në këtë rast, thithja e përfitimeve nga sektori publik – e parë nga këndvështrimi i efikasitetit – po aq të dëmshme sa edhe për shembull, heqja e mbrojtjes së patentës. Monopolet bëhen problematike vetëm kur ato ngulin këmbë. Pavarësisht nga kjo, teoria e konkurrencës monopolistike tregon se kjo nuk pritet në rastet e monopoleve të zakonshme. Në këtë kontekst, misioni i shtetit është të parandalojë kartelat dhe fiksimin e çmimit kështu që përfitimet monopoliste të mund t'i merren konkurruesve. Shembuj të konkurrencës monopolistike ka në industrinë e pijeve. Birra “Tirana”, për shembull, është furnizuesi i vetëm i birrës shqiptare, por nuk ka arsye për ta luftuar këtë pozicion monopolistik duke qenë se kjo është një konkurrencë për mallra të zëvendësueshëm.

Situata në sektorin e telekomunikacionit është ndryshe. Ky sektor është një monopol i natyrshëm dhe për rrjedhojë, karakterizohet nga të ardhura në rritje sipas shkallës. Ka ekonomi sipas shkallëve, por nuk ka konkurrencë monopolistike. Në situata të tilla, shteti duhet të ndalojë flakjen e konkurruesve jashtë tregut nëpërmjet kufizimeve ligjore. Pikërisht për këtë arsye, në Gjermani është ngritur një agjenci rregullatore, me qëllim vëzhgimin e tregut dhe vendosjen e çmimeve tavan për shërbimet e telekomunikacionit. Për momentin, Qeveria Gjermane ka parashikuar bazën ligjore për përfshirjen në përgjegjësitë e agjencisë edhe të rregullores mbi energjinë dhe gazin.

3.7 Rishpërndarja dhe mbështetja e zhvillimit ekonomik

Në diskutimin e deritanishëm, aktivitetet e sektorit publik janë justifikuar kryesisht mbi bazat e efikasitetit. Një pjesë e madhe e shpenzimeve publike në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian i shkojnë, gjithsesi individëve në formën e transfertave dhe kompanive në formën e subvencioneve⁸. Transfertat për individët i shërbejnë qëllimeve të shpërndarjes. Ndërsa, subvencionet ndaj kompanive janë pjesë e promovimit të zhvillimit ekonomik. Në politikën e përditshme buxhetore, shpenzimet për promovimin e zhvillimit ekonomik përbëjnë pa dyshim grupin më të madh. Kjo bie në kundërshtim me logjikën e ekonomisë së tregut. Nëse, masat që nxisin ekonominë mund të merren vetëm përkohësisht, ato i shërbejnë qëllimit të tyre nëse mund të shfuqizohen shpejt. Nëse masa të tilla merren në mënyrë ngulmuese, ato sigurojnë struktura që janë jo konkurruese nga ana ekonomike dhe çojnë në humbje të mëdha të mirëqenies.

⁸ Në Gjermani, në vitin 2001, vëllimi total i transfertave dhe i subvencioneve arriti afërsisht në 6 për qind të PBB-së, shih BMF (2001).

Politika e përbashkët e agrikulturës së Bashkimit Evropian është pa dyshim një shembull paralajmërues në këtë kontekst. Përafërsisht 50 për qind e buxhetit vjetor të Bashkimit Evropian, buxhet prej rreth 100 miliardë eurosh, përdoret për të subvencionuar produktet bujqësore evropiane, domethënë, ajo ka si synim të ulë çmimet e kostos së tyre në nivelin e tregut botëror. Ky “promovim i konkurrencës” afatgjatë të prodhuesve bujqësorë evropianë, është pa dyshim një çorientim i jashtëzakonshëm i konkurrencës së tregut të lirë, që çon në humbje të mëdha të konsumatorëve evropianë.

Shembuj të tjerë të subvencioneve të pakuptimta nga ana ekonomike janë ato të prodhimit të duhanit në Evropë apo prodhimi i qymyrit në Gjermani. I pari është akoma më kontradiktor, përse shteti synon në të njëjtën kohë parandalimin e konsumit të duhanit nëpërmjet taksave të larta. E fundit është joproduktive nga ana ekologjike. Që të dy shembujt kanë të përbashkët faktin se një ndërprerje e subvencionimeve të prodhimit, duke i drejtuar ato pagesa drejt individëve të angazhuar në procesin e prodhimit, janë asnjans nga ana e buxhetit, por arrijnë në të ardhura vjetore të individit më të larta se mesatarja⁹. Në të njëjtën kohë, kjo zgjidhje mund të sjellë përfitime duke larguar çrregullimet në çmime.

Pak shembuj bëjnë të qartë se veçanërisht shpenzimet publike për promovimin e zhvillimit ekonomik duhen ndjekur si macja miun. Megjithatë, ekziston edhe një tjetër kategori “e padukshme” e shpenzimeve: lehtësitë fiskale. Në këtë kontekst, i referohemi **shpenzimeve të taksave**, duke qenë se lehtësitë e taksave nuk janë gjë tjetër veçse një heqje dorë nga të ardhurat e siguruara prej tyre. Në Gjermani, shpenzimet federale të taksave arritën në afërsisht 6.4 për qind e të ardhurave të taksës federale në vitin 2002.

Tabela 1 ilustron me shembuj nga buxheti federal gjerman për vitin buxhetor 2002 sesi në shumë fusha, shpenzimet në formën e transfertave dhe të subvencioneve karakterizojnë shpenzimet e përgjithshme.

⁹ Në vitin 2000, subvencioni i prodhimit të qymyrit arriti afërsisht 70.000 euro në një të punësuar (!).

Tabelë 1: Madhësia dhe përbërja e shpenzimeve të Qeverisë Federale të Gjermanisë për vitin buxhetor 2002, në miliardë euro dhe në përqindje të shpenzimeve totale (vlera të rumbullakosura).

	Euro	Përqindje
Sigurimet Shoqërore	105,353	42.57%
këtu:		
1. Kontributet e sigurimeve shoqërore	72,179	29.16%
2. Tregu i punës	15,316	6.19%
3. Ndihma familjare	3,940	1.59%
4. Pagesa rezidente	2,100	0.85%
5. Mbështetje për viktimat e luftës	3,787	1.53%
6. Masa e politikës sociale në sektorin e bujqësisë	4,103	1.66%
7. Shpenzime të tjera në politikën sociale	2,767	1.12%
Mbrojtja	23,761	9.60%
Mbrojtja e konsumit, ushqimi dhe bujqësia	1,450	0.59%
1. Detyrimet e komunitetit (Niveli shtetëror dhe federal)	872	0.35%
2. Shpenzime të tjera në bujqësi	578	0.23%
Nxitja e zhvillimit ekonomik	8,297	3.35%
1. Energjia	3,276	1.32%
2. Nxitja e sektorëve të tjerë	640	0.26%
3. Sipërmarrje të vogla dhe të mesme, kërkimet dhe teknologjia	793	0.32%
4. Zhvillimi ekonomik rajonal	1,021	0.41%
5. Garancitë etj.	2,567	1.04%
Transporti	20,865	8.43%
këtu:		
1. Hekurudhat	11,368	4.59%
2. Autostradat	5,519	2.23%
3. Mjetet e transportit nëpër bashki	1,677	0.68%
4. Transporti detar	1,588	0.64%
Ndërtimi	2,587	1.05%
1. Ndërtimi i shtëpive dhe zhvillimi urban	1,990	0.80%
2. Godinat e Parlamentit dhe Qeverisë	597	0.24%
Kërkime, arsimit dhe shkenca, kultura	11,025	4.45%
1. Shkenca, kërkimet dhe zhvillimi (përveç universitetit)	6,520	2.63%
2. Universitetet	1,427	0.58%
3. Nxitja e kërkimeve të reja shkencore	1,113	0.45%
4. Arsimimi profesional dhe fusha të tjera të arsimit	492	0.20%
5. Kultura	1,473	0.60%
Mbrojtja e mjedisit, shëndeti, sportet	2,109	0.85%
Mbrojtja e brendshme	2,692	1.09%
Bashkëpunimi ekonomik dhe zhvillimi	3,621	1.46%
Shpenzime të përgjithshme publike	65,740	26.56%
këtu		
1. Pagesat e interesave	38,971	15.75%
2. Pagesat e pensioneve	14,443	5.84%
Shpenzime gjithsej	247,500	100.00%

Burimi: BMF (2002) dhe llogaritje të bëra vetë

4 Si të matim përmasat e sektorit publik?

Përmasat e sektorit publik mund të maten me anë të shpenzimeve të një shteti. Këto shpenzime mund të klasifikohen ose sipas qëllimit të funksioneve të shtetit siç tregohet në tabelën 1 për rastin e buxhetit federal të Gjermanisë, ose sipas llojit të shpenzimeve. Të dyja klasifikimet, gjithsesi, çojnë në të njëjtin përfundim nëse të gjitha buxhetet publike integrohen në një **buxhet të bashkuar**. Një buxhet i tillë përmban shpenzimet e qeverisë federale, të shtetit dhe të qeverive vendore (mbas një konsolidimi të brendshëm). Ekzistojnë gjithashtu, konsiderata për të integruar buxhetin e siguracionit shoqëror në buxhetin e bashkuar. Vënia e shpenzimeve totale të sektorit publik në raport me PBB-në, do të çojë në **raportin e shpenzimeve qeveritare**, që tregon përqindjen e totalit të shpenzimeve të një ekonomie, realizuar në përgjegjësinë e shtetit për çdo vit. Siç u përmend edhe në fillim, ky raport i shpenzimeve qeveritare është rreth 50 për qind, çuditërisht i lartë në shumicën e vendeve evropiane.

Eliminimi i shpenzimeve të sigurimeve shoqërore nga shpenzimet e përgjithshme dhe marrja parasysh e pagesave në Fondin e Sigurimeve Shoqërore më tepër si një “kontribut i sigurimeve shoqërore” sesa si një “taksë e sigurimeve shoqërore”, do të rezultonte në një **raport të ngushtë të shpenzimeve qeveritare**, rreth 30 për qind për Gjermaninë në vend të 50 për qind. Në një kontekst ndërkombëtar, ky raport i ngushtë është shumë më tepër përfaqësues sepse ka diferencë të madhe në financimin dhe në nivelin e mbulimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore në vende të ndryshme. Kur trajtojmë raportin e ngushtë të shpenzimeve qeveritare, është e mundur të gjykojmë në mënyrë të pavarur nga ndikime demografike, nëse një sektor publik është zgjeruar apo është zvogëluar përgjatë viteve.

Është interesante se si shembulli i Gjermanisë tregon se sasia aktuale e shpenzimeve të vogla të qeverisë është rreth të njëjtit nivel me atë të vitit 1965. Megjithatë, ka patur rritje dhe rënie thelbësore në dekadat e fundit. Këto lëvizje ndërlidhen me qeveri të ndryshme dhe me preferencat e tyre specifike për aktivitetet e tregut apo jashtë tregut.

Fatkeqësisht, shpenzimet buxhetore konvencionale mund të japin një përshtypje jo të saktë mbi shkallën në të cilën burimet e një shoqërie janë nën kontrollin e qeverisë. Për këtë ka dy arsye: ekzistenca e artikujve jashtë buxhetit dhe kostot e fshehura të qeverisë¹⁰.

Aspekti i artikujve **jashtë buxhetit** përfshin të gjitha kompanitë shtetërore dhe pjesëmarrjet në kompanitë private të mbajtura nga shteti. Aspekti i dytë, ai i **kostove të fshehura nga qeveria** përfshin të gjitha ato aktivitete rregullatore të shtetit, të cilat nuk prekin direkt shpenzimet shtetërore, por që gjithsesi rezultojnë në kosto të larta për ata që u duhet t’iu përmbahen këtyre rregulloreve. Kështu, rregulloret e tepërta dhe burokracia e fryrë, për shembull, mund të çojnë në kosto të fshehura sepse rritja vështirësohet dhe në të njëjtën kohë, burimet private bashkohen në mënyrë joefikase.

Këta dy shembuj tregojnë se çështja e përmasave të sektorit publik mund të zgjidhet fare lehtë po të konsiderohen vetëm kriteret formale apo ato fiskale. Një përgjigje ekonomike e kënaqshme, ndonëse do të kërkonte integrimin në raportin e shpenzimeve

¹⁰ Shih Rosen për këtë aspekt (1992).

qeveritare të pjesës së burimeve ekonomike, që sektori publik nuk e disponon. Pa hyrë në detajet e kësaj çështjeje, mund të pranonim se përdorimi i një raporti të tillë të shpenzimeve qeveritare do të zmadhonte akoma më shumë diferencën në krahasimin mes Evropës dhe SHBA.

Çorientuese do të ishte edhe përpjekja për të matur përmasat e sektorit publik me anë të numrit të të punësuarve në shtet. Në procesin e tranzicionit, numri i të punësuarve në shtet mund të jetë një tregues i vlefshëm për suksesin e procesit të ristrukturimit drejt një ekonomie tregu. Megjithatë, roli i vërtetë i sektorit publik mund të matet vetëm nëse burimet e bashkuara në punën e përdorur publike të mund të mateshin me produktivitetin e tyre. Numri aktual i të punësuarve nga qeveria si edhe rinumërimi i tyre, nuk është e thënë të jenë tregues të mjaftueshëm për këtë.

Deri tani i jemi referuar anës së shpenzimeve publike për të matur përmasat e sektorit publik. Pa dyshim, mund të konsideronim, gjithashtu, të ardhurat publike si bazë për këtë masë.

Tabela 2 tregon struktura të **Buxheteve të Unifikuara të Gjermanisë**, në vitin 2002, në formë agregate. Përmasa (fiskale) e sektorit publik mund të matet gjithashtu, si shuma e raportit të të ardhurave nga taksat me PBB-në, raporti i taksës sociale me PBB-në, raporti i të ardhurave të veçanta (për shembull të ardhura nga privatizimi, fitime të Bundesbank) me PBB-në, dhe raporti i deficitit me PBB-në.

Tabelë 2: Struktura Buxhetit të Unifikuar të Gjermanisë për vitin 2002, në përqindje me PBB-në (vlera të rrumbullakosura).

Shpenzimet	Përqindja ndaj PBB-së	Të ardhura	Përqindja ndaj PBB-së
Buxhetet federale, shtetërore dhe vendore	30	Taksat	20
Sigurimet shoqërore	20	Sigurimet shoqërore	20
		Buxheti i kapitaleve, e të tjera	7
		Deficiti	3
Σ	50	Σ	50

Burimi: Ilogaritje të bëra vetë.

Nga pikëpamja e anës së të ardhurave, problemet financiare të buxheteve publike mund të përmblihen si më poshtë. Raporti gjerman i të ardhurave nga taksat ndaj PBB-së në vitin 2002 është një ndër më të ulëtët që nga viti 1949, dhe në vitin 2002 ai ishte gjithashtu më i ulëti në të gjithë Evropën. Rrjedhimisht, raporti i deficitit ndaj PBB-së ishte ende 3 për qind, ndonëse ka patur një raport mjaft të lartë të të ardhurave të veçanta ndaj PBB-së, raport ky 7 për qind. Ky shembull bën të qartë se një raport i ulët i të ardhurave nga taksat ndaj PBB-së, nuk përbën absolutisht një tregues të **ngarkesës** taksore të mbledhur nga sektori privat apo shkallën e rolit të shtetit në ekonomi. Thelbësore për përcaktimin e kësaj ngarkese janë kostot e fshehura, të shkaktuara nga rregullore që vështirësojnë rritjen. Dhe janë pikërisht këto kosto të fshehura ato që janë

përgjegjëse për faktin që Gjermania ka ritmin më të ulët të rritjes ekonomike në Evropë për momentin. Rrjedhimisht, një politikë ekonomike që synon zvogëlimin e përmasave të sektorit publik vetëm nëpërmjet lehtësive të taksave, nuk do të ketë asnjë ndikim në origjinën e problemeve të rritjes.

Duke përmbledhur rezultatet e këtij kapitulli do të nxirrim dy përfundime. Nga njëra anë, përmasat e sektorit publik përfshijnë në terma ekonomike shkallën në të cilën shteti pretendon burime ekonomike. Nga ana tjetër, kjo shkallë pa dyshim nuk mund të matet duke marrë parasysh të ardhurat totale të shtetit. Kur masim këtë shkallë duke marrë parasysh anën e shpenzimeve, është thelbësore të integrojmë të gjithë artikujt e papërfshirë në buxhet, për të marrë një rezultat më real.

5 Zhvillimet e sektorit publik në vendet e Ballkanit Perëndimor

Në Shqipëri, shpenzimet e përgjithshme qeveritare (që përfshijnë shtetin, bashkitë dhe fondet ekstra të buxhetit) në harkun kohor 1995-2002, janë të krahasueshme me rastin e Gjermanisë nëse maten me përcaktimin e raportit të ngushtë të shpenzimeve qeveritare ndaj PBB-së, siç tregon dhe tabela 3. Për më tepër, kjo lidhje është relativisht e qëndrueshme në të gjithë periudhën e në të njëjtën kohë, më e ulëta në krahasim me Bosnje-Hercegovinën, me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, madje edhe me Kroacinë.


Siç tregon tabela 4, deficitet fiskal përpara fondeve, gjithsesi, është 7 - 8 për qind më shumë se mesatarja. Kjo mund të shpjegohet nga një situatë jo e mirë në marrjen e të ardhurave nga tatimet dhe nga procedurat e privatizimit. Krahasuar me fillimin e procesit të transformimit, situata është përmirësuar mjaft, por në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, problemi i deficitit fiskal në Shqipëri është më i rëndi.

Duke interpretuar këtë pikë nën dritën e rritjes së prodhimit në ekonominë shqiptare, e cila ra nga 6.5 për qind në vitin 2001 në 4.7 për qind në vitin 2002 – por ishte, dhe ende është, më e larta krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor – ecuria e dobët e deficitit fiskal qeveritar të përgjithshëm tregon akoma më shumë se problemi ka si origjinë një sistem taksash që funksionon dobët.

Deficiti fiskal shton borxhin e përgjithshëm qeveritar, dhe siç dhe e shohim nga tabela 5, në vitin 2002, Shqipëria kishte raportin e borxhit ndaj PBB-së afërsisht 65 për qind, që është më i lartë se ai kroat, i cili është rreth 57.5 për qind në vitin 2002. Ky është një interpretim i gabuar i të dhënave të krahasuara. Por, interpretimi pozitiv është se kur raporti i borxhit të Kroacisë rritet vazhdimisht, raporti shqiptar qëndron relativisht konstant.


Tabelë 3: Shpenzimet e përgjithshme qeveritare në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe mesatarja (e pamatur) arithmetike 1995-2002 (në përqindje të PBB-së).¹¹

¹¹ Të dhënat për vitin 2002 janë vlerësime. Zhvillimi i shpenzimeve të përgjithshme qeveritare për secilin vend paraqitet me anë të kolonave dhe mesatarja aritmetike me vijë të trashë.



Burimi: BERZH (2003), Rifreskimi i raportit të tranzicionit, maj.


Tabelë 4: Deficiti fiskal përpara fondeve në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe mesatarja arithmetike (e pamatur) 1991 –2003 (në përqindje të PBB-së).¹²



Burimi: BERZH (2003), Rifreskimi i raportit të tranzicionit, maj.

¹² Të dhënat janë vlerësime për vitin 2002 dhe projeksione për vitin 2003. Zhvillimi i deficit fiskal përpara fondeve për secilin vend paraqitet me anë të kolonave dhe mesatarja arithmetike me vijë të trashë.

Tabelë 5: Borxhi i përgjithshëm qeveritar në Shqipëri dhe Kroaci dhe mesatarja arithmetike (e pamatur) 1995 – 2002 (në përqindje të PBB-së).¹³



Burimi: BERZH (2003), Rifreskimi i raportit të tranzicionit, maj.

6 Vërejtjet përmbyllëse.

Ekonomistët e dinë se shpenzimet qeveritare dhe raporti i PBB-së që qeveritë shpenzojnë, nuk janë kriteret e duhura për të gjykuar nëse sektori publik në një vend të caktuar është shumë i madh apo shumë i vogël. Faktori përcaktues është krahasimi i **përfitimeve** nga shpenzimet qeveritare dhe **kostot e financimit** të këtij shpenzimi, duke përfshirë **humbjet e rënda** të shoqëruara me metodën e financimit të atij shpenzimi¹⁴.

Përfitimet mund të maten si dobishmëri neto, vetëm për shkak të kostove oportune të përdorimit të burimeve të pakta ekonomike.

Financimi i taksave përfshin dy ngarkesa, ngarkesën e taksës në vetvete dhe **ngarkesën e tepërt**, që rezulton nga çrregullimet e taksave. Ngarkesa e parë nuk duhet të evitohet, dhe e dyta vetëm mund të zvogëlohet nëpërmjet një taksimi inteligjent me një bazë të gjerë taksash dhe me një raport të ulët të taksave marxhinale.

Financimi i borxhit, nga ana tjetër nuk e përfshin ngarkesën e parë, por vetëm të dytën duke kufizuar mundësitë e taksapaguesve të ardhshëm për të zgjedhur. Duke qenë se kostot që dalin prej saj mund t'i kalojnë së ardhmes, qeveritë kanë një tendencë tipike për të reaguar në një mënyrë miope. Dhe kjo është arsyeja pse ky lloj financimi duhet kufizuar nëpërmjet kufizimeve ligjore.

Përveç kostove të financimit dhe dobishmërisë së programeve të shpenzimeve, ekziston dhe një kategori e tretë: kostot e fshehura të një qeverie që dalin nga rregullat. Këto kosto të fshehura janë të vështira për t'u matur, por dikush mund të mendojë se ato janë mjaft të mëdha.

¹³ Të dhënat për vitin 2002 janë vlerësime. Zhvillimi i borxhit të përgjithshëm të qeverisë për secilin vend paraqitet me anë të kolonave dhe mesatarja arithmetike me vijë të trashë.

¹⁴ Shih Fekdstein (1996) për koncepte të diskutueshme të përmasave.

Atëherë, cili është thelbi i një politike të mirë të sektorit publik? E para, të kufizojë shpenzimet publike deri në fushat më thelbësore të aktivitetit publik; e dyta, të financojë aktivitetet publike me nivele taksash të ulëta; e treta, të marrë borxh deri në nivelin e shpenzimeve të investimeve publike dhe e katërta, të paraqesë rregulla kufizues në mënyrë mjaft të kujdesshme.

Referenca

- AKERLOF, GEORGE (1970). The Market for Lemons: Quality Uncertainty and the Market Mechanism. In: Quarterly Journal of Economics 84.
- BUNDESMINISTERIUM DER FINANZEN (2002). Finanzbericht 2003. Berlin.
- BUNDESMINISTERIUM DER FINANZEN (2001). Achtzehnter Subventionsbericht. Berlin.
- EUCKEN, WALTER (1952). Grundsätze der Wirtschaftspolitik. Tübingen.
- EUROPEAN BANK FOR RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT (2003). Transition Report Update. May. London.
- FELDSTEIN, MARTIN (1996). How Big Should Government Be? NBER Working Paper 5868. NBER. Cambridge, MA.
- MUSGRAVE, RICHARD A. (1959). The Theory of Public Finance. Mac Graw Hill. New York.
- ROSEN, HARVEY S. (1992). Public Finance. Richard Irwin. Homewood, IL.
- STIGLITZ, JOSEPH E. (2002). Globalization And It's Discontents. W.W. Norton. New York, London.
- WORLD BANK (1997). World Development Report. Oxford University Press. New York.